

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRI E MËDITËS DHE TËRHEQIT DHE PËRQINDËS DHE INXHIINIERËVE MINISTRI E MËDITËS DHE TËRHEQIT DHE PËRQINDËS DHE INXHIINIERËVE MINISTRI E MËDITËS DHE TËRHEQIT DHE PËRQINDËS DHE INXHIINIERËVE	
Niveli Organi Organi Nr. Faj Nr. Shkoll Nr. Pages	Nr. Faj Nr. Faj Nr. Faj Nr. Faj Nr. Faj
DPINB / /	8653/24 31.12.24 31.12.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 10, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4, Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafit 3.5 dhe Nenit 40, paragrafit 5, të Ligjit nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr.1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

RREGULLORE PËR TAKSAT DHE TARIFAT E ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i taksave dhe tarifave të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda) dhe mënyrës së pagesës së tyre.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Odën dhe inxhinierët që aplikojnë ose licencohen nga Oda, si dhe praktikantët të cilët regjistrohen në Odë.

Neni 3

Përkufizimet

- Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).
- Emrat në njërin gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

Neni 4
Taksat dhe tarifat e Odës

1. Taksat dhe tarifat që paguhën në Odë janë si në vijim:

1.1. Licenca për anëtarët e Odës (kartela identifikuese dhe vula për herë të parë)	100 €
1.2. Rilicencimi (kartela e re identifikuese)	50 €
1.3. Anëtarësia një (1) vjeçare e anëtarit të rregullt në Odë	100 €
1.4. Anëtarësia një (1) vjeçare e anëtarit praktikant në Odë	50 €
1.5. Njohja e licencës së lëshuar jashtë vendit – ushtrimi i veprimtarisë profesionale në mënyrë të vazhdueshme	100 €
1.6. Njohja e licencës së lëshuar jashtë vendit – ushtrimi i veprimtarisë profesionale në mënyrë të përkohshme ose sipas rastit	100 €
1.7. Kartela e re identifikuese në rast të dëmtimit ose humbjes	10 €
1.8. Vula e re në rast të dëmtimit ose humbjes	30 €

2. Bordi Drejtues i Odës mund të përcaktoj taksa dhe tarifa tjera nga ato në paragrafin 1, në përputhje me rregulloret përkatëse të Odës.

Neni 5
Detyrimi për pagesë

1. Inxhinierët e licencuar dhe ata që aplikojnë për licencim, si dhe praktikantët që regjistrohen në Odë, janë të obliguar t'i paguajnë taksat dhe tarifat e parapara në këtë Rregullore.
2. Mos përmbushja e detyrimit për të paguar anëtarësinë konsiderohet shkelje disiplinore dhe është bazë për pezullimin e licencës të anëtarit të Odës.


Neni 6
Mënyra e pagesës së taksave dhe tarifave

Taksat dhe tarifat e Odës paguhën në afatin e përcaktuar nga organi përkatës i Odës. Me funksionalizimin e Sistemit Elektronik, Administrata e Odës mundëson pagesën elektronike të taksave dhe tarifave të Odës.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Raptua



Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës